

VENDIM
Nr. 62, datë 10.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “GJO SPA POWER”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pikat 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Gjo Spa Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GJO SPA POWER” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “GJO SPA POWER” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani